



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 175/19 Prot.

Koplik, më 07/04/2026

V E N D I M

Nr. 17 ,date 02.04.2026

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës Financiare për familjen e

Zotit ZEF KOLË MARASHI banesa e te cilit është djegur nga zjarri

Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe ne mbledhje e dates 02.04.2026 me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur në Ligjin 139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, neni 54, shkronja“dh“,Ligjin 45,neni30,41 pika 1,2,3, datë 18.07.2019“Për Emërgjencat Civile“, VKM_së nr.329 date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“,Udhezimi i perbashkët i Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrisë së Financave Nr.263,date 224.05.2013 „Për kriteret dhe procedurat dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKB Nr 61.date 24.12.2025,Per miratimin e buxhetit të Vitit 2026.

V E N D O S I:

1-Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për ndihmen e menjëherëshme financiare familjes së z. Zef Kolë Marashi në vlerën **100.000**(njeqindëmijë) lekë, për djegjen e banesës së saje nga zjarri.

2-Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin“**Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**“, në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe për **vitin 2026** te miratuar me VKB. .61..date 24.12.2025 në programin_“Perballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet në raste fatkeqesie“.

3-Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe per familjen e z. Zef Kolë Marashi në vlerën e dëmit nga ana ndertimore në shumën **6,245,356.6** (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë presje gjashtë) lekë, 50% i

saj është **3,122,678.3** (tre milionë e njëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë presje tre) lekë, si dhe vlera e dëmit në paisje është **1,098,200** (një milionë e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind) lekë ku 50% i saj është **549,100** (pesëqind e dyzet e nëntë mijë e njëqind) lekë. Sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Malësi e Madhe. Vlera totale e dëmeve është **7,343,556.6** (shtatë milionë e treqind e dyzet e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë presje gjashtë) lekë ku 50% i saj është **3,671,778.3** (tre milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë presje tre) lekë. Burimi i financimit për mbulimin e këtij shpënzimi do të jetë transferi dhe kushtëzuar e alokuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe AKMC për fatkeqesi natyrore.

4-Ngarkohet administrata e bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumës prej **100.000**(njëqind mijë) lekë.

5-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.

6-Ky vendim hyne në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit Nr.139/2015 „ Per veteqeverisjen vendore“

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 02.04.2026

Vota Pro 17

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 03.04.2026

